



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 2/2021 (JR)
Datë 14.01.2021

Vendim nr. 23 (JR)
Datë 23.07.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 23.07.2021, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Ornela Balla, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Gentian Lile, me funksion ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 320, datë 09.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës. Neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin ose rrëzimin e vendimit nr. 320, datë 09.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me pikën e dytë të dispozitivit të vendimit që

përcakton ndalimin e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, duke kërkuar mosaplikimin e këtij kufizimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Gentian Lile ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kërkesën me objekt: “Dorëheqje nga ushtrimi i detyrës së ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër”. Këtë dorëheqje, subjekti i rivlerësimit e ka bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 56 të ligjit nr. 84/2016.
3. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”) ka marrë vendimin nr. {***}, datë 21.10.2020, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, z. Gentian Lile, për shkak të dorëheqjes”. Ndaj këtij vendimi të KLGJ-së¹, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Komisioni, më datë 07.12.2020, nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën private (*e-mail*) të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 ka informuar këtë të fundit, sipas parashikimit të nenit 46, pika 1 e këtij ligji, mbi të drejtën për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore dhe në vijim e ka ftuar të shprehë vullnetin nëse dëshiron të ushtrojë këtë të drejtë. Subjekti i rivlerësimit, më datë 09.12.2020, në përgjigje të këtij komunikimi elektronik, ka informuar Komisionin se nuk do të marrë pjesë në seancë dëgjimore.
5. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Lile, me vendimin nr. 320, datë 09.12.2020.
6. Subjekti i rivlerësimit z. Gentian Lile, më datë 28.12.2020, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 320, datë 09.12.2020, duke kundërshtuar vetëm pikën 2 të dispozitivit të tij, me përmbajtje: *Ndalimin e emërimit të z. Gentian Lile, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar*

¹ Referuar përgjigjes së përcjellë KLGJ-së nga Gjykata Administrative e Apelit me nr. {***} prot., datë 01.12.2020, rezulton se pranë kësaj gjykate nuk është paraqitur ankim nga subjekti i rivlerësimit kundër vendimit të KLGJ-së nr. {***}, datë 21.10.2020.

i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

7. Komisioni, me vendimin nr. 320/1, datë 05.01.2020, ka vendosur të pranojë ankimin e subjektit Gentian Lile, duke e konsideruar si ankim të plotë dhe në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Vendimi nr. 32/1, datë 27.01.2020, “Për pranimin e ankimit” u është njoftuar përkatësisht palëve

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 320, datë 09.12.2020, vendosi:
 1. *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Lile, si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër (përfunduar në datën 4.11.2020).*
 2. *Ndalimin e emërimit të z. Gentian Lile, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare [...].*

III. Shkaqet e ankimit

9. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 9.1 Subjekti pretendon se ndalimi i bërë në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionit, nuk është i drejtë dhe duket si një dënim penal për ndalimin e ushtrimit të një funksioni publik.
 - 9.2 Dorëheqja, sipas subjektit, nuk ka pasur synim shmangien nga procesi i rivlerësimit, përkundrazi, edhe pse ka dashur të japë dorëheqjen më parë, nuk e ka bërë duke pritur e shpresuar që rivlerësimi ndaj tij të kryhej sa më shpejt. Arsyeja e dorëheqjes ka qenë mostrajtimi si subjekt rivlerësimi, pra mospërfitimi i pagës në masën 75% të pagës së gjyqtarit të gjykatës ku subjekti ushtronte detyrën si ndihmës ligjor. Subjekti pretendon se i është shkelur një e drejtë themelore, referuar pikës 2 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konkretisht pabarazia e trajtimit financiar, mospërfitimi i pagës si të gjitha subjektet e tjera të rivlerësimit.
 - 9.3 Subjekti i rivlerësimit shprehet se *procesi i rivlerësimit është ngritur që të largojë nga sistemi i drejtësisë ato subjekte të cilat, nga pozicioni i tyre, kanë qenë vendimmarrës, ndërkohë që ai nuk ka qenë në pozicion vendimmarrës dhe as në pozicion këshillimi që mund të ndikonte në vendimmarrje, por ka qenë një punonjës i thjeshtë gjykatë. Në këto kushte, subjekti pretendon se funksioni si ndihmës ligjor nuk mund të ndikonte në funksionimin e shtetit të së drejtës, në pavarësinë e sistemit të drejtësisë apo në humbjen e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.*
10. Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji që, pas shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankim, të vendosë: *Ndryshimin ose rrëzimin e vendimit nr. 320, datë 09.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 320, datë 09.12.2020, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

14. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shkaqe të ndryshme që e kanë çuar në paraqitjen e kërkesës për dorëheqje nga detyra. Konkretisht, në kërkesën drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, KLGJ-së dhe Institucionit të Presidentit, subjekti Gentian Lile rendit si shkak arsyet familjare, ndërsa në

ankimin e paraqitur pranë Kolegjit, ngriti si pretendim mostrajtimin e duhur financiar gjatë ushtrimit të detyrës si “ndihmës ligjor” pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër. Të dyja arsyet e parashtuara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues nuk i konsideroi relevante, duke vlerësuar faktin se qëllimi i veprimtarisë së Kolegjit në rastet e dorëheqjes nga detyra të subjekteve të rivlerësimit, nuk është analizimi i arsyeve që kanë çuar subjektin në dorëheqje, por verifikimi i vullnetit të tij të pavesuar për t’u larguar nga ushtrimi i funksionit që e bën subjekt rivlerësimi.

15. Fillimisht dorëheqja është shqyrtuar nga ana e KLGj-së që, me vendimin nr. {***}, datë 21.10.2020, vendosi *ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, z. Gentian Lile, për shkak të dorëheqjes*, vendim i cili nuk rezultoi të ishte kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga ana e subjektit të rivlerësimit.
16. Në rastin objekt shqyrtimi, nga trupi gjykues, dorëheqja e subjektit të rivlerësimit nga detyra e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, u vlerësua si një akt vullneti i lirë për të ndërprerë detyrën funksionale që e bënte z. Gentian Lile subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës.
17. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk ka shfaqur në asnjë moment vullnet për t’iu shmangur apo për të ndërprerë procesin e rivlerësimit dhe se ndalimi në pikën 2 të vendimit të Komisionit është penalizues, trupi gjykues çmoi të mbajë në konsideratë jurisprudencën² e deritanishme të Kolegjit për çështje të ngjashme, ku ka arsyetuar se vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit në dispozitat kushtetuese dhe në ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit.
18. Trupi gjykues, nga analizimi i kërkesës për dorëheqje të subjektit, konstatoi se vetë subjekti i rivlerësimit ka referuar si bazë ligjore pikërisht nenin G të Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit i kishte të qarta pasojat dhe efektet juridike që do të sillte dorëheqja e tij nga detyra, pasi paraqitja e saj sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, çon direkt në vendosjen e ndalimit të përkohshëm prej 15 vitesh në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara shprehimisht në pikën 2 të këtij neni. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues ka arritur në përfundimin se vlerësimi nëse kufizimi i parashikuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës është penalizues apo jo, nuk mund të jetë objekt i gjykimit në Kolegj, për sa kohë që ai është një parashikim kushtetues i cili aplikohet vetëm në rastet e dorëheqjes nga detyra.
19. *Sa i përket pretendimit të subjektit se ndalimi i bërë në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionit nuk mund të zbatohet në rastin e tij pasi ai nuk ka qenë në pozicion vendimmarrës dhe as në pozicion këshillimi që mund të ndikonte në vendimmarrje, por ka qenë një punonjës i thjeshtë gjykatë*, trupi gjykues çmon fillimisht të theksojë se subjekti e ka fituar këtë cilësi (subjekt rivlerësimi) për shkak të parashikimit kushtetues në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës: *Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të*

² Shih vendimin nr. 17/2019 (JR), paragrafi 21.4 dhe vendimin nr. 18/2020 (JR), paragrafi 19 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

Për sa kohë që subjekti i rivlerësimit ka qenë në funksionin e ndihmësit ligjor në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, dhe ka dhënë dorëheqjen nga ky funksion përgjatë procesit të rivlerësimit, gjen vend edhe zbatimi i pikës së dytë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, e cila përcakton ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar si gjyqtar, prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokuror i Përgjithshëm apo Inspektor i Lartë i Drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare.

Në të njëjtën frymë ka arsyetuar dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 78, datë 12.12.2017, paragrafi 43, tek shprehet: *Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*

20. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore nuk bëjnë dallim apo parashikim ndryshe për subjektet e rivlerësimit në raport me funksionin që ata ushtrojnë, gjyqtarë, prokurorë apo ndihmës ligjorë, për sa kohë që janë subjekte të rivlerësimit në kuptim të nenit 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se këto dispozita, të interpretuara në harmoni me nenin G të Aneksit të Kushtetutës, i cili është i aplikueshëm për të gjitha subjektet e rivlerësimit, pa bërë diferencime në kategori, gjyqtarë, prokurorë, ndihmës ligjorë, afektojnë me efektet e tyre edhe subjektin e rivlerësimit Gentian Lile.

Sa më sipër, në kuptim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, duke pasur parasysh dhe jurisprudencën³ e deritanishme të Kolegjit, trupi gjykues arriti në përfundimin se ankimi i paraqitur nga subjekti Gentian Lile nuk mbështetet në ligj.

21. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues e gjen të drejtë vendimin e Komisionit dhe çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi dorëheqja e tij nga detyra ka sjellë si efekt ligjor ndërprerjen e procesit të rivlerësimit e, për pasojë, humbjen e së drejtës për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Për këtë arsye, vendimi i Komisionit nr. 320, datë 09.12.2020, është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

³ *Shih vendimet nr. 42 (JR), datë 28.12.2020; nr.18 (JR), datë 29.07.2020; nr.6 (JR), datë 16.02.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit*

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 320, datë 09.12.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Lile.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 23.07.2021

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi